



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 230/25 Dt. 04.04.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b, d dhe g të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) neni 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, neni 9 të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Themelohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të ardhur nga OJQ-të dhe Individëve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit për ndarje të subvencioneve. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Arben Rashkaj,..... kryesues,
 - 1.2. Sahadete Sadikaj,.....anëtare,
 - 1.3. Imerdin Kukaj,.....anëtar,
 - 1.4. Xhevdet Dervishaj,anëtar rezervë.
2. Detyrat e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve të përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë të caktuara në Rregulloren MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe ligjet dhe aktet të tjera nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
3. Mandati i Komisionit të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi do të jetë konform paragrafit 3 të nenit 9 të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komisioni i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Komisionit të lartcekur,
 - Arkivës së Kryetarit

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

